



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. ____ Prot

Tiranë, më ____ 2018

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i referencës së procedurës: REF-87472-09-26-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash” me fond limit 37,212,612 (tridhjeteshtatë milion e dyqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: 12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Publikime të mëparshme (*jo*): Buletini i Njoftimeve Publike data 01.11.2018, Nr. 39.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|--|---|
| 1) BOLT shpk <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> Vlera: 31.767.500 (tridhjetë e njëmilion e shtatëqindgjashtëdhjetëeshtatë mijë e pesëqind) lekë (pa TVSH) (<i>me numra dhe fjalë</i>) | K91517011V <i>numri i NIPT-it</i> |
| 2) ERZENI/ SH shpk <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> Vlera: 36.000.000 (tridhjetëegjashtëmilion) lekë (pa TVSH) (<i>me numra dhe fjalë</i>) | J66902027T <i>numri i NIPT-it</i> |
| 3) “M. LEZHA” shpk <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> Vlera: 37.000.000 (tridhjetëeshtatëmilion) lekë (pa TVSH) (<i>me numra dhe fjalë</i>) | J76504013C <i>numri i NIPT-it</i> |
| 4) BOE: Trinity Trade Company shpk + W.CENTER shpk K63029402A <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | K81630026U + <i>numri i NIPT-it</i> |

Vlera: **33.323.200** (tridhjetëetremilion e treqindnjëzetëetremijë e dyqind) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)

- 5) **E M K O shpk** **K61424016V**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: **34.994.600** (tridhjetëekatërmilion e nëntëqindnëntëdhjetëekatërmijë e gjashtëqind)
lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)
- 6) **ERALD shpk** **J74517205P**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: **35.800.342** (tridhjetëepesëmilion e tetëqindmijë e treqindedyzetëedy) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)
- 7) **BUNA shpk** **J61826501C**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: **37.071.100** (tridhjetëeshtatëmilion e shtatëdhjetëenjëmijë e njëqind) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)
- 8) **SHAGA shpk** **J96822229J**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: **36.774.100** (tridhjetëeshtatëmilion e shtatëdhjetëenjëmijë e njëqind) lekë (pa TVSH)
(me numra dhe fjalë)
- 9) **“RO-AL” shpk** **J61811001M**
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera: **0** (zero) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

- 1) Operatori ekonomik “RO-AL SHPK” shpk me numër J61811001M me ofertë ekonomike **0**
(zero) lekë pa TVSH

“1. Ofertuesi nuk plotëson kriteret e përgjithshme për kualifikim sepse nuk ka paraqitur vetëdeklaratë me shkrim sipas Shtojcës 8.

2. Ofertuesi nuk plotëson kriteret e përcaktuara në gërmat “b”, “c” dhe “d” të pikës 2/1 të kriterëve të vecanta për kualifikim, sepse nuk ka paraqitur deklaratat sipas shtojcës 6 dhe shtojcës 7 të DT. Po ashtu, vërtetimi i lëshuar nga OSHEE sh.a nuk përfshin shlyerjen e detyrimit të maturuar të energjisë elektrike të muajit gusht 2018.

3. Ofertuesi nuk plotëson kriteret e përcaktuar në pikën 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të kriterëve të vecanta për kualifikim të DT, sepse nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar përmbushjen e këtyre kriterëve teknike.

4. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gërmën “ç” të pikës 2/1 të kriterëve të vecanta për kualifikim të DT, sepse nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.”

- 2) Operatori ekonomik "EMKO" shpk me numër K61424016V me ofertë ekonomike 34.994.600 (tridhjetëekatërmilion e nëntëqindnëntëdhjetëekatërmijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH

"1. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gërmën "ç" të pikës 2/1 të kriterëve të vecanta për kualifikim të DT, sepse ka tejkalar fondin limit të autoritetit kontraktor D.P.Policisë. Ofertuesi ka plotësuar dhe ofertuar për dy tabelat e vecanta të autoritetit kontraktor D.P.Policisë në vlerën 23.914.800 lekë (pa TVSH), pra 183.366 leke (pa TVSH) mbi fondin limit të këtij autoriteti në vlerën prej 23.731.434 leke (pa TVSH). Vlera e ofertuar e tejkalon buxhetin e autoritetit kontraktor të parashikuar për këtë procedurë.

2. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 4 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të kriterëve të vecanta për kualifikim të DT, sepse në deklaratën e paraqitur për 3 (tre) nga artikujt që nuk janë prodhime druri (makinë grirëse letre, ndricues statik, ndricues tavoline), nuk përcaktohet kompania prodhuese dhe vendi i origjinës së tyre.

3. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të kriterëve të vecanta për kualifikim të DT, sepse nuk ka paraqitur foto të ambienteve të punës (prodhimi ose magazinimi).

4. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 9 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të kriterëve të vecanta për kualifikim të DT, sepse nuk ka paraqitur katalogë / broshura / foto ilustruese ose cdo lloj dokumentacioni tjetër teknik, ku të paraqiten specififikimet teknike të disa prej artikujve që oferton."

- 3) Operatori ekonomik "SHAGA" shpk me numër J96822229J me ofertë ekonomike 36.774.100 (tridhjetëeshtatëmilion e shtatëdhjetëenjëmijë e njëqind) lekë pa TVSH

"1. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gërmën "ç" të pikës 2/1 të kriterëve të vecanta për kualifikim të DT, sepse ka tejkalar fondin limit të autoritetit kontraktor D.P.Policisë. Ofertuesi ka plotësuar dhe ofertuar për dy tabelat e vecanta të autoritetit kontraktor D.P.Policisë në vlerën 24.529.800 lekë (pa TVSH), pra 798.366 leke (pa TVSH) mbi fondin limit të këtij autoriteti në vlerën prej 23.731.434 leke (pa TVSH). Vlera e ofertuar e tejkalon buxhetin e autoritetit kontraktor të parashikuar për këtë procedurë.

2. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 9 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të kriterëve të vecanta për kualifikim të DT, sepse katalogët / broshurat / fotot ilustruese të paraqitura, nuk përmbushin specififikimet teknike të artikujve që oferton."

- 4) Operatori ekonomik "BOE - Trintity Trade Company & W.Center" shpk me numër K81630026U + K63029402A me ofertë ekonomike 33.323.200 (tridhjetëetremilion e treqindnjëzetëetremijë e dyqind) lekë pa TVSH

"1. Ofertuesi BOE - Trintity Trade Company & W.Center, nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 3 të seksionit 2.1 "Kapaciteti ligjor-profesional" sepse anëtari i BOE - W.CENTER ka paraqitur një çertifikatë për cilesinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001:2007, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit Royalcert i paakredituar për OHSAS 18001:2007 nga ndonjë organizëm kombëtar ose ndërkombëtar akreditues."

- 5) Operatori ekonomik "ERALD" shpk me numër J74517205P me ofertë ekonomike 35.800.342 (tridhjetëepesëmilion e tetëqindmijë e treqinddyzetëedy) lekë pa TVSH

"1. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.2 "Kapaciteti ekonomik-financiar", sepse nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilancit të vitit 2017.

2. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik", sepse nuk ka paraqitur dokumentacion për te pakten 1 (nje) punonjes të punësuar si Inxhinier druri (nuk ka paraqitur diplome dhe kontratë pune të vlefshme)."

6) Operatori ekonomik " BUNA" shpk me numër J61826501C me ofertë ekonomike 37.071.100 (tridhjetëeshtatëmilion e shtatëdhjetëenjëmijë e njëqind) lekë pa TVSH

"1. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të kriterëve të vecanta për kualifikim të DT, sepse nuk ka paraqitur dokumentacion për te pakten 1 (nje) punonjes të punësuar si Inxhinier druri (nuk ka paraqitur diplome dhe kontratë pune të vlefshme).

2. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gjurmën "d" të pikës 2/1 të kriterëve të vecanta për kualifikim të DT, sepse vërtetimi i lëshuar nga OSHEE sh.a nuk përfshin shlyerjen e detyrimit të maturuar të energjisë elektrike të muajit gusht 2018.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

Operatori ekonomik "BOLT" SHPK, me nr. NIPT K91517011V me ofertë ekonomike, 31.767.500 (tridhjetë e njëmilion e shtatëqindëgjashtëdhjetëeshtatëmijë e pesëqind) Lekë (pa TVSH) me adresë: Rruga "Dritan Hoxha", Blloku Gintash,, Laprakë, Tiranë.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë Ministrisë së Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë, Tel:042 247 865, menjëherë nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 15.11.2018

Ankesa: JO

**TITULLAR I ORGANIT QËNDROR BLERËS
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**